



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008 , nenit 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të dt.26.09.2008, Shkresës përcjellëse të MAPL-së Nr.020-241/16 të datës 18.04.2019 si dhe Njoftimit : Rivlerësimi i Grantit të Performancës Komunale të Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr.454-666/11 të datës 28.12.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 19. 01.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM

PËR PEZULLIMIN TË VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC 15NR.463-14826 I DATËS 04.03.2019

- I. PEZULLOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për Varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019 .
- II. Vendimi i cekur pezullohet deri në përfundimin e procedurës gjyqësore të inicuar nga pala paditëse përkitazi me pronën komunale të dhënë në shfrytëzim sipas Vendimit të cekur në pikën I të këtij Vendimi .
- III. Pas përfundimit të arsyeve që kanë shkaktuar pezullimin e zbatimit të Vendimit i njëjti do të miratohet në njërin nga seancat e ardhëshme të Kuvendit të Komunës i harmonizuar edhe me rekomandimet e cekura në Shkresën përcjellëse të MAPL-së dhe legjislacionin në fuqi .
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektorit Pronësor Juridik , Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër .
- V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

15Nr. 463 - 4331

Lipjan, më 19. 01. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

